

Prof. dr. Kristo Frashëri

**HIMARA
DHE PËRKATËSIA ETNIKE E
HIMARIOTËVE**

(Bisedë me historianët grekë)

Tiranë 2004

Ka mjaft kohë që në Greqi e Shqipëri, në faqet e shtypit të përditshëm ose të trajtesave të veçanta rrihet çështja e Himarës, më saktë çështja e banorëve të saj. Sipas autorëve helenë këta banorë i takojnë kombësisë greke, kurse sipas palës tjetër i takojnë kombësisë shqiptare. Të dy palët sjellin argumente në dobi të pikëpamjeve të tyre, por nuk shoshitin argumentet e palës tjetër. Kjo nuk është pa dobi, por është rrugë e lehtë për secilën pikëpamje. Të sjellësh argumente në dobi të tezës tënde duke injoruar ato të palës kundërshtare nuk është debat shkencor. Me këtë metodë problemi mbetet i pazgjidhur dhe të dy palët qëndrojnë të gozhduara pas pikëpamjeve të tyre. Pikërisht për këtë arsye për të dhënë sadopak një kontribut në zgjidhjen e këtij problemi që ngacmon marrëdhëniet midis dy popujve fqinje, autori i këtij punimi ka përgatitur një monografi me titull “Himara në burimet dokumentare historike” ku bëhet një orvatje për të ballafaquar argumentat e të dy palëve. Këtu po botojmë një përmledhje të çështjeve kryesore të trajtuara në këtë monografi, e cila do të botohet së shpejti. Sikurse do të shihet, me këtë ballafaqim ai arrin në përfundimin se banorët e Himarës i përkasin pa mëdyshje kombësisë shqiptare. Megjithatë nëse ka arritur ta sarojë përfundimisht problemin, do ta thonë lexuesit.

Nga pikëpamja e gjeografisë historike Himara ka një vështrim të trefishtë: është emër i një qendre të banuar (*Qyteza e Himarës*), emër i një bashkësie krahinore (*Krahina e Himarës*) dhe emër i një dioqeze kishtare (*Peshkopata e Himarës*). Nuk ka dyshim se burimin fillestar të këtij emërtimi të trefishtë e ka emri Himarë i vendbanimit (sot qytezë, dikur fshat) që ndodhet në bregdet, në pjesën veriore të detit Jon. Për hir të pozitës së saj gjeografike, Himara si qendër e banuar më vonë i dha emrin bashkësisë krahinore bregdetare, e cila sot përfshin shtatë fshatra (Himarë, Palasë, Dhërmi, Vuno, Kudhës, Pilur, Qeparo), kurse dikur në periudha të ndryshme, sikurse do të shihet, përfshinte me dhjetra fshatra, herë dhjetë e ca, herë njëzet ose tridhjetë e ca, herë dyzet, madje dhe pesëdhjetë e ca fshatra. Më tej emrin e mori dioqeza kishtare e ritit lindor, peshkopata e

Himarës e varur nga patriarkati i Kostandinopojës, kurse në kohën kur u krijua dioqeza nën vartësinë e Papatit të Romës, u quajt Kisha e Akrokeraunëve (*Ecclesia Acroceraunia*), nën sufraganinë e Kryepeshkopatës Katolike të Durrësit.¹

Krahina e sotme e Himarës apo siç e quajnë shqiptarët *Bregu i Detit*, ose thjesht *Bregu* – edhe historiani grek V. D. Zoto Molossoi e quante më 1878 *μπρεγυδευ/ bregudeti*² - shtrihet në shpatin perëndimor të maleve të Himarës, të cilat në burimet antike greke quheshin malet Keraune (*Akrokeraune, Malet e Vetëtimës*)³, kurse F.C.H.L. Pouqueville në fillim të shekullit të XIX i quan Malet e Labërisë (*Iapygie ou Iapourie*)⁴. Shpati ku janë renditur fshatrat zbrit me një pjerrësi të theksuar deri në buzë të detit Jon. Malet e Himarës (Akrokeraune) me majat e tyre më të larta: mali i Çikës (2045 m), maja e Lapjetës (1198 m), maja e Lugjes (1046 m) e ndajnë krahinën e Himarës nga ajo e Kurveleshit. Në veri Himarën e ndan nga krahina e Vlorës, vargu i Karaburunit, me shtegun kryesor, Qafën e Llogarasë (1027 m). Në jug krahina e Himarës, pasi përfshinte edhe kepin e Porto Panormos, kufizohej me Borshin, i cili në Mesjetë ishte kryeqendër e një bashkësie krahinore më vete – krahina e Sopotit.

Në mbarë krahinën e Himarës mbisundon klima mesdhetare. Nga verilindja vargu i Karaburunit dhe i Çikës (malet Keraune) e mbrojnë atë

¹ D. Farlati. *Illyricum sacrum*. Vol. VII, Venetiis 1817, ff. 434-436.

² V.D.Zotos-Molosos. *Hpeirwtikai meletai*. Vëll. 4, Athinë 1878, f. 77.

³ Scylax, *Periplus* 26,27. Scymnus. *Orbis description* 364. Apollodorus. *Bibliotheca*. I, 137. J. Ceasar. *Bellum Civile* III, 6, 3. Straboni. *Geographica* I. 21; IV, 316, 317, 318, 324, 326. Lucanus. *Pharsalia* II 45; V, 93. Pomponius Mela. *De geographia* II, 3, 54. Plinius (Maior). *Naturalis historia* III, 23; 26, IV. Suetonius. *De vita Ceasarum* Aug. 17. Arrianus. *Historia successorum Alexandri* A 1, 9 A 7. Pausanias. *Descriptio Graeciae* I, 13, 1; V 22,4. Appianus. *Bella civilia* II, 54. Rovenatis Anonymus. *Cosmographia* V, 13.

⁴ *Voyage de la Grece* (2-eme edition). Paris 1826, f. 307.

nga murlani dimëror. Me këtë pozicion klimaterik krahina e Himarës, në tërësi me toka të pakta bujqësore, ka kultivuar kurdoherë, përveç

Figure :Bregdeti i Himarës. Pikturë nga H. W. Williams (1829).

blegtorisë, dy kulturat kryesore mesdhetare: ullinjtë dhe agrumet, pa përjashtuar vreshtat. Pozicioni gjeografik i ka detyruar banorët e krahinës të lidhen nga pikëpamja ekonomike jo vetëm me tokën, por edhe me detin – me detin jo aq me peshkimin sesa me lundrimin.

Një ndikim të veçantë në krahinën e Himarës kanë ushtruar marrëdhëniet me krahinën fqinje malore të Kurveleshit. Si pasojë e këtyre marrëdhënieve shekullore banorët e të dy këtyre krahinave shqiptare fqinje – Himarës dhe Kurveleshit – në shumicën e rasteve kanë qenë farefis midis tyre. Kjo lidhje e ngushtë farefisnore ka ndikuar edhe në gjeografinë politiko-administrative të kësaj treve. Për zyrtarët bizantinë dhe osmanë, të cilët e kundronin trevën nga Lindja, Himara si krahinë ishte në prapashpinë të trevës së Gjirokastrës (Kurveleshit) ose të Delvinës. Për këtë arsye administrata osmane fshatrat e saj i përfshinte në njësinë administrative të Kurveleshit ose të Delvinës. Përkundrazi për zyrtarët dhe eruditët perëndimorë, sidomos italikë, të cilët e kundronin trevën nga perëndimi, në ballë ishte krahina e Himarës, kurse Kurveleshi dhe Delvina qëndronin në prapashpinë të saj. Si rrjedhim mjaft vendbanime të Kurveleshit dhe të Delvinës janë përfshirë prej tyre në listën e fshatrave të krahinës së Himarës. Me këto dy këndvështrime të kundërta shpjegohet arsyeja përse në burime bizantine dhe osmane emri i Himarës si bashkësi krahinore zakonisht zhduket dhe përse te burime perëndimore krahina e Himarës, sikurse u tha, shfaqet si njësi gjeografike herë me pak e herë me dhjetra fshatra.

Pavarësisht nga këto luhatje, Himara si krahinë ka qenë dhe vazhdon të jetë një bashkësi etnografike më vete. Si e tillë ajo ka përfshirë, siç përfshin edhe sot, shtatë fshatrat e përmendura. Banorët e saj, duke përfshirë dhe ata që njohin greqishten kanë midis tyre një kulturë popullore të njëjtë në të gjitha drejtimet – në doket, zakonet, këngët, vallet, veshjet, legjendat dhe mentalitetet. Madje, himariotët kanë një kulturë popullore gati të përafërt, me atë të banorëve fqinjë të Labërisë. Sikurse do të shihet në vendin e duhur banorët e saj kanë patur gjithashtu një të drejtë zakonore të përbashkët të shprehur në gjuhën shqipe (venomet). Edhe normat kanunore të banorëve të Himarës kanë afëri me ato të Labërisë, sado që sot ato u përkasin besimeve fetare të ndryshme, të parët të krishterë, të dytët myslimanë. Këtë e dëshmojnë materialet e regjistruara gjatë ekspeditave etnografike që janë ndërmarrë gjatë dhjetëvjeçarëve të kaluar në këto krahina.⁵

Megjithatë në gjirin e fshatrave të saj ka një dallim në një pikë të rëndësishme. Tre nga vendbanimet e krahinës – Palasa, Himara dhe Dhërmiu – flasin brënda dhe jashtë shtëpisë shqip dhe greqisht.

Figure Malet Keraune (Akrokeraune). Ed. Lear (1845).

Katër fshatrat e tjerë brënda dhe jashtë shtëpisë flasin vetëm shqip. Duhet patur parasysh se tre fshatrat e përmendura i kanë banesat e tyre afër detit. Për këtë arsye ato merreshin kryesisht me lundrim, kurse kopshtarinë dhe blegtorinë e kishin si ekonomi ndihmëse. Pothuajse çdo familje kishte mjetin e saj të lundrimit, dikush anije, dikush varkë, sipas fuqisë ekonomike.

⁵ I. Elezi. *Edrejta zakonore e Labërisë*. Tiranë 2002. Shih veçanërisht ff. 22-26, 101-110.

Banorët e katër fshatrave të tjerë (Vuno, Qeparo, Kudhës dhe Pilur) me banesat e tyre në kodrina, larg buzës së detit, nuk merreshin, me ndonjë përjashtim, me detari, pra nuk kishin mjete lundrimi. Ata merreshin me kopshtari, blegtori dhe me emigracion. Si rrjedhim, sa herë që krahina e Himarës bëhej pre e fushatave ushtarake osmane, familjet e fshatrave kodrinore ngarkonin mbi kuaj teshat e shtëpisë dhe sëbashku me familjet dhe bagëtitë e tyre strehoheshin përkohësisht në krahinën e Kurveleshit. Përkundrazi, banorët e tre fshatrave të buzëdetit, meqënëse nuk i merrnin dot anijet në krah, pasi ngarkonin mbi to familjet dhe orenditë e domosdoshme, lundronin në viset që nuk ndodheshin nën sundimin turk – në ishujt grekë Jonianë (Korfuz) ose në brigjet italiane të Puljes dhe riatdhesoheshin, nganjëherë edhe pas disa vitesh, kur largohej rreziku turk. Dëshminë më të hershme për largimin e përkohshëm në rast rreziku të banorëve të Himarës, pjesërisht nëpër tokë dhe pjesërisht nëpër det, e kemi nga kronisti venedikas i fundit të shek. XV Stefano Magno. Duke përshkruar fushatën që ndërmoi sulltan Bajaziti II në vitin 1486 kundër Himarës kryengritëse, ai shkruan se kundër saj u nisën dy sanxhakbejlerë turq për të ndjekur banorët që u larguan nga toka (nënkuptohet drejt maleve të Labërisë). Në të njëjtën kohë, me porosi të sulltanit “dolën nga Vlora gjashtë fuste (anije – K.F.) dhe erdhën te ai bregdet për të penguar që ata popuj të mos iknin me barkë ndër ishuj (*per divedar che quelli populi con barche non fusizeno alle isole*)”.⁶

⁶ C. N. Sathas. *Documents relatif a l'histoire de la Grece o au Moyen-Age*. Vol. VI. Paris 1886, f. 236. I. Zamputi. *Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë. Vëll. IV (1479-1506). Pjesa I (1479-1499)*. Tiranë 1967, ff. 100-101.

Këto largime të përkohëshme do të na shpjegojnë depërtimin e greqishtes (dikur, sikurse e pohojnë vetë krerët himariotë në një letër të tyre të vitit 1759, edhe të italishtes)⁷ tek banorët e tyre.

Njoftimin më të hershëm se banorët e Himarës, Dhërmiut dhe Palasës flisnin greqisht e kemi nga kronisti grek i Janinës Panajot Aravantinoi në veprën e tij *Kronografia e Epirit*,⁸ botuar në 1856. Themi më të hershëm mbasi para Aravantinoit, me përjashtim të një pohimi të diskutueshëm që ndeshet në vitin 1729 (i cili do të trajtohet më tej), banorët e trevës himariote, përfshirë edhe ato të tre fshatrave “greqishtfolëse”, përmenden jo si grekë, por si shqiptarë të krishterë. Kronisti grek P. Aravantinoi në lidhje me Himarën, njofton se gjuha që flitej në Himarë (me 180 shtëpi), në Dhërmi (me 200 shtëpi) dhe Palasë (me 80 shtëpi), ishte greqishtja, kurse në Vuno (me 180 shtëpi), Pilur (me 30 shtëpi), Qeparo (me 200 shtëpi) dhe Kudhës (me 30 shtëpi) flitej, sipas tij, greqisht dhe shqip.

Figure : Përfytyrimi i krahinës së Himarës dhe i Sopotit nga një gjeograf venedikas në shek. XVII.

Asnjë prej këtyre njoftimeve nuk është i saktë. Sikurse do të shihet, në tre fshatrat e para flitej edhe greqisht edhe shqip, kurse në katër fshatrat e tjera sipas dëshmisë së udhëtarit anglez, Ed. Lear, i cili e vizitoi krahinën e Himarës në ato vite (1848), pra në kohën e P. Aravantinoit, flitej vetëm

⁷ Letra në origjinalin italisht ruhet në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë. Moskë. Fondi: “Marrëdhëniet e rusisë me Malin e Zi”, 1755, dok. nr. 35, f. 159. Letra në përkthimin shqip është botuar në: *Dokumentë të pabotuara mbi marrëdhëniet e popullit shqiptar me Rusinë në shek. XVIII*. Në: “Buletin për shkencat shoqërore”, 2 (1955), ff 156-162.

⁸ P. Aravantinos. *Crwnograqia ths Hpeirou*. Vëll. II. Athinai 1856.

shqip.⁹ Megjithatë, vetë Aravantinoi në pjesën enciklopedike të veprës së tij, te zëri Himarë (Χειμαρρα) thotë se vetëm tre fshatrat greqishtfolëse i përkisnin, pa dhënë asnjë dëshmi historike, kombësisë (*filisë*) greke, kurse katër fshatrat e tjerë banoreshin, shkruan ai, nga shqiptarë. Më vonë me thellimin e vazhdueshëm të nacionalizmit helenik filloi të zinte një vend të rëndësishëm në publicistikën dhe historiografinë greke teza se gjithë shqiptarët ortodoksë nuk ishin gjë tjetër veçse helenë, të cilët gjuhën e tyre amtare, greqishten, e kishin zëvendësuar me shqipen. Megjithatë jo të gjithë e përqaftuan këtë tezë. Kështu p. sh. Kristo Suli, në zërin *Himarë* të shkruajtur prej tij në Enciklopedinë e Madhe Greke (*Enciklopedia Pirsos*) përsërit tezën e Aravantinoit, ndonëse as ky nuk citon ndonjë burim dokumentar që të vërtetojë përkatësinë etnike greke të tre fshatrave të Himarës¹⁰. Përkundrazi, Al. Mamopullos, një grekoman ekstremist i dhjetëvjeçarëve të kaluar, shkon më tej. Pasi njofton se krahina e Himarës përfshinte 13 fshatra, shkruan se tetë prej tyre qenë fshatra greke (ελληνες): Himara, Coraj, Qeparo, Kudhësi, Piluri, Vuno, Dhërmiu, Palasa, kurse pesë fshatrat e tjerë (me banorë myslimanë – K.F.) qenë shqiptare (αλβανοί): Kuçi, Bolena, Borshi, Ftera, Kallarati¹¹. Një pikëpamje disi të përfaqësues ka shfaqur edhe linguisti grek. Ev. Ath. Boga bashkëkohës i Aleksandër Mamopullit. Në trajtesën e tij të botuar në vitin 1966 kushtuar të folmeve të greqishtes veriore (të Epirit) në të cilin i kushton një kapitull të veçantë Himarës, ai shkruan, gjithnjë pa sjellë asnjë burim dokumentar historik: “Himara si krahinë autonome përmbledhë nëntë fshatra nga të cilat tre (Himara, Palasa, Dhërmiu) ishin greqishtfolës (ελληνοφωνά), kurse

⁹ Eduard Lear. *Journals of a Landscape painter in Albania*. London 1852.

¹⁰ Megali Ellinike. *Enciklopedia*. Vëll. 24, Athinai 1934, f. 543

¹¹ Al. Momopoulos. *Hpeiroz*. Vëll. I, Athinai 1961, f. 199.

gjashtë të tjerat kanë harruar gjuhën greke dhe tani janë shqipfolëse (albanofonë)¹²”.

Sot në përgjithësi edhe historiografia shqiptare pranon se banorët e këtyre tre fshatrave, ndonëse jo të gjithë, e njohin greqishten. Por origjinën e saj historianët shqiptarë e shpjegojnë me ndikimin që ka ushtruar kisha greko-fanariote në Shqipëri dhe pjesërisht me kontaktet tregtare që këto fshatra kanë patur me qendra tregtare të afërta greke, kryesisht me Korfuzin dhe me ishujt e tjerë jonianë. Por, nëse është e vërtetë se greqishtja përdorej në familje edhe nga gratë, këta dy faktorë nuk janë bindës. E para se kisha fanariote dhe shkolla greke kanë vepruar jo vetëm në këta tre fshatra greqishtfolës të Himarës, por edhe në fshatrat e tjerë me banorë ortodoksë të Shqipërisë Jugore, kurse popullsia mbeti vetëm shqipfolëse. E dyta, se kontaktet tregtare të himariotëve me grekët, mund të shpjegojnë depërtimin e greqishtes tek burrat, por jo tek gratë. Por këto shpjegime janë të pamjaftueshme.

Sikurse shihet midis historianëve shqiptarë dhe atyre grekë ka pikëpamje të kundërta në tre drejtime. Sipas të parëve, banorët e këtyre tre fshatrave i përkasin kombësisë shqiptare dhe e kanë greqishten si gjuhë të dytë, sipas shkrimtarëve helenë ata i përkasin kombësisë greke dhe e kanë shqipen si gjuhë të dytë. E dyta, sipas të parëve idioma greqishte e këtyre tre fshatrave ka depërtuar nga jashtë në kohët e vona, sipas të dytëve ajo është me origjinë mesjetare, madje antike. E treta, të parët e besojnë konstatimin e vëzhguesit të mprehtë anglez W. M. Leake, i cili pasi vizitoi Himarën më 1804 thotë: “Pothuajse të gjithë burrat dinë greqisht dhe ata që kanë qenë në kurbet flasin edhe italisht; por gratë përgjithësisht s’dinë asnjë gjuhë tjetër

¹² Ev. Ath. Boga. (Μπογκα). *Ta gl wssika idiwmata tez epeirgn*. Vëll. II. (Κερ Β’). Janinë 1996 (Τγωσσριν Χιμαρραζ Δρνμαδν Παλιασαζ), f. 77

veçse shqipes”¹³, kurse të dytët nuk e kanë kundërshtuar me argumenta pohimin e M. Leake, i cili e thotë shkoqur se greqishtja në kohën e tij nuk ishte gjuhë familjare.

Historianët helenë e shohin origjinën “greke” të himariotëve te emigrimi i tyre nga trojet e Greqisë në bregun e Himarës. Përderisa banorët antikë të kësaj treve kanë qenë kaonët, të cilët i përkisnin etnikonit ilir, rruga që atyre u mbetej ishte hulumtimi në fushën e dokumentacionit mesjetar me shpresë se mund të gjenin ndonjë shenjë shtegtimi popullsisht helene nga treva e Elladës në brigjet e Himarës. Meqënëse historianët medjevistë grekë nuk gjetën, as në periudhën mesjetare gjurmë shtegtimesh nga ndonjë kënd i Greqisë drejt brigjeve të Jonit, çështjen e morën në dorë linguistët helenë. Sipas metodologjisë së tyre kur në fushën e studimeve historike mungojnë burime dokumentare të mirëfillta, në vend të tyre, rëndësi të dorës së parë marrin studimet linguistike, më saktë krahasimet dialektologjike, brenda së njëjtës gjuhë.

Sinjalin e parë në këtë drejtim e dha A. Petridhi në fund të çerekut të tretë të shek. XIX. Duke u mbështetur në disa pika takimi midis greqishtes së Himarës dhe dialektit dorik, ai nxori përfundimin se himariotët ishin kolonë grekë të ardhur nga Peloponezi. Tekstualisht ai thotë: “Himariotët flasin shqip dhe greqisht ndërmjet fshatrave, shqip me shqipfolësit dhe greqisht me greqishtfolësit, por në greqishten e tyre ka elementë (fonetik dhe leksik) që tregojnë për ndikim të dialektit dorik”.¹⁴ Shtatë vjet më vonë V. D. Zotos-Molosoï thotë se: “Grekët e bregdetit të Himarës (Οι Έλληνες του Μπρεγουμετι Χιμαραζ), mbahen si kolonë të maniotëve

¹³ William Martin Leake. *Travels in Northern Greece*. Vëll. I. London, 1835, ff. 112-114.

¹⁴ A. Petridi. *Cronikon Druopidoz, Neolihnika Anal ekta, t. A, mer. B, en A θηναίς*. 1871, f. 37.

sepse ngjasojnë në moral, karakter dhe në shqiptimin e gjuhës”.¹⁵ Një çerek shekulli më vonë N. Mustakidhi mendoi se e sqaroi përfundimisht prejardhjen e himariotëve kur shkrojti se disa himariotë i kishin thënë atij se stërgjyshërit e tyre kishin ardhur nga krahina e Manit të Peloponezit¹⁶. Mustakidhi nuk ishte një historian, por një dhaskal fshati, i cili u jepte rëndësi të tepruar tregimeve të pleqve, aq më tepër që në këtë rast ata ndoshta ishin ndikuar nga punimi i V. D. Zotos-Molosoit. Si rrjedhim, njoftimi i tij nuk kishte vlerën e një burimi historik, por vetëm një nxitje për të bërë kërkime dhe për ta vërtetuar ose rrëzuar me burime dokumentare tregimin e pleqve. Por, meqënëse “zbulimi” i Mustakidhit i kënaqte prirjet nacionaliste helenike, historianët e mëvonshëm grekë, të cilët zakonisht në të tilla raste referojnë njëri-tjetrit, e pranuan njoftimin e tij, jo si sugjerim por si fakt historik.

Por ka edhe autorë helenë që sjellin si dëshmi të origjinës greke të himariotëve nga Mani ngjashmërinë që kanë disa norma të rëndësishme të së drejtës zakonore të dikurshme të banorëve të këtyre dy krahinave. Ata sjellin si shembull, normën e së drejtës zakonore që ka lidhje me pozicionin e dikurshëm juridik të gruas, e cila si në Himarë ashtu dhe në Mani, edhe pas martesës, edhe pasi lindte fëmijë, vazhdonte t’i takonte fisit të prindërve të saj. Ata sjellin gjithashtu si shembull, normën tjetër, se në të drejtën zakonore të të dy vendeve martesa konsiderohej e konsumuar (realizuar) jo me kurorëzim, por me lindjen e fëmijës së parë dhe se kur gruaja nuk lindte fëmijë, burri kishte të drejtë të merrte një grua të dytë, pa e dëbuar gruan e parë. Por këto pika takimi midis tyre rrjedhin jo ngase himariotët qenë grekë

¹⁵ V.D.Zotos-Molossos. *Hpeirwtikai mel etai*. Vëll. 4, Athinë 1878, f. 77.

¹⁶ N. Mustakidi. *I. Heimarra len imorologio “Iperitikos astir”*. Athinai 1904, f. 273.

të ardhur nga Mani, por ngase banorët e Manit, sikurse do të shihet më tej, qenë shqiptarë (arvanitë) të vendosur gjatë shtegtimeve që mbushën Peloponezin në shek. XIV. Dëshmi është fakti se këto norma të Manit nuk janë të ngjashme vetëm me normat e lashta të Himarës, por me ato të dikurshme të mbarë shqiptarëve të Shqipërisë. Kurse nga ana tjetër këto norma zakonore të maniotëve nuk kishin ngjashmëri me ato të fqinjëve të tyre grekë.

Një shpjegim për t'u patur parasysh për historinë e greqishtes së Himarës është ai që dha gjuhëtari danez Hoëg më 1925. Duke studiuar gjuhën e himariotëve të pashkolluar, të vendosur në Korfuz, ai e pranoi afërinë e të folmes së himariotëve me greqishten jugore të Manit, por nuk e sheh prejardhjen e saj nga Mani. Sipas tij e folmja greqishte e Himarës ka afëri me të folmen e kolonëve maniotë të shpërngulur nga Mani dhe të vendosur në Pulje (Itali Jugore) në shek. XV¹⁷. Gjithnjë sipas tij, që këtej këta kolonë "maniotë" pas katastrofës që pësuan turqit në Otranto në vitin 1480, u shpërngulën nga Pulja dhe u vendosën në Himarë. Këto mërgime dhe rimërgime (të maniotëve nga Mani ose nga Pulja në Himarë), e vështirësuan më tepër problemin mbasi, si njëra ose tjetra shpërngulje nuk dëshmohehin nga burime dokumentare. Në të vërtetë ka ndodhur e kundërta nga ajo që thotë Hoëg. Sikurse do të shihet janë himariotët ata që emigruan përkohësisht në periudha të ndryshme në Pulje gjatë ekspeditave turke. Ka pra mundësi që takimet gjuhësore të himariotëve me të folmen maniotë të shpjegohen me kontaktet e vazhdueshme të himariotëve që kanë vizituar gjatë shekujve Puljen, ku kishte kolonë maniotë. Gjithsesi për Hoëg-un ka rëndësi fakti se në të folmen greqishte të Himarës ka ndikime jo vetëm nga

¹⁷Hoëg. *Aqhna*, 36 (1925), f.291(Sipas D.V.Vaiakakos). *Il wssika kai laograqi ka Cimapas B. Hepeiroz kai Maniz*. Thessaloniki 1983, ff. 13-14.

dialektet greke jugore të Peloponezit, por edhe nga dialektet greke veriore të fqinjëve të saj. Por edhe këto takime gjuhësore mund të shpjegohen me qëndrimet e shpeshta të himariotëve sëbashku me familjet e tyre në ishujt grekë të Jonit, gjatë ekspeditave turke kundër Himarës.

Më në fund vlen të përmendet këtu edhe pikëpamja e shfaqur nga M. Dhendhiani më 1926, i cili nuk e pranon vendosjen e maniotëve në Himarë. Duke polemizuar me linguistin danez Hoëg, ai anon më tepër nga teza se himariotët nuk janë kolonë grekë të ardhur as nga Mani, as nga Pulja. M. Dhendhiani thotë se: “Është më e besueshme të pranojmë se himariotët janë pasardhës të banorëve të vjetër të periudhës mesjetare bizantine, kurse tradita që flet për prejardhjen e tyre nga Mani ka rrjedhur nga ngjashmëria që këto dy krahina kanë patur në fushën e të drejtës zakonore dhe nga rezistenca e tyre e përbashkët përballë invazionit turk”.¹⁸

M. Dhendhiani nuk na sjell dëshmi historike që të provojnë praninë gjatë mesjetës paraturke të banorëve grekë në Himarë. Përkundrazi, burimet historike mesjetare para dhe pas vitit 1481 i emërtojnë banorët e Himarës ose “shqiptarë” ose thjesht “himariotë”, por asnjëherë “grekë”. Mjafton të përmendim kronistin bizantin të shek. XV Laonik Kalkokondili, i cili duke folur për jehonën që pati fushata e Janosh Huniadit në Shqipëri kundër ushtrive osmane në nëntorin e vitit 1443 (pra gati katër dekada para vitit 1481) trevën e Himarës e përfshin në emërtimin “Bregdeti i Maqedonisë pranë Jonit” dhe lë të kuptohet se banorët e saj qenë “shqiptarë”, të cilët u bashkuan me Depë Zenevisin dhe marshuan për të çliruar Argjiropolihnin (Gjirokastrën). Megjithatë tezën e M. Dhendhianit e mbështeti historiani

¹⁸M.Dhendhiani. *Apoula kai Cimara, Il wssikai kai istorikai sceseis tw n Ellhnikwn autwn plhqusmwv*, Αυτοθι 38 (1926), 76 (Sipas D. V. Vaiakakos. *Poaty*, f. 13)

gjerman G. Stadtmüller, i cili ka shkruar më 1934 se: “Ishulli gjuhësor (γλωσσική νησί) i Himarës nuk është koloni, një ngulim i helenizmit Puljan i themeluar nga fundi i shek. XV, por më i vjetër. Ishulli,- vazhdon historiani gjerman, - është më tepër i rrethuar, i bllokuar nga nënshtresa bizantine dhe është ruajtur që nga epoka kur grupi i dialekteve greko-veri-perëndimore dhe jugo-greke e mbizotëruan krahinën vazhdimisht. Ajo krahinë u copëtua nga agresioni sllav dhe pjesa e bregdetit të Epirit mbeti në duart e bizantinëve”.¹⁹ Por edhe ky është një supozim, mbasi Stadtmüller-i tezën e tij nuk e ndriçoi me burime dokumentare.

Deri në mes të shek. XX gjuhëtarët grekë e trajtuan greqishten e folur në tri fshatrat e Himarës si pjesë e një idiome të vetme pa lidhje as me greqishtjen e Dropullit, as me atë të Vurgut, as me atë të krahinave të tjera të Epirit. Siç u tha ata e panë lidhjen e saj vetëm me dialektin e greqishtes jugore të Manit (Peloponez). Por, gjuhëtari grek Ath. Boga nxorri më 1966 një përfundim interesant. Sipas tij të folmet greqishte së tri fshatrave të Himarës, nuk i takojnë të njëjtës idiomë, por të paktën dy idiomave të ndryshme, njëra nga të cilat flitej në Himarë, tjetra në Dhërmi dhe Palasë. Si rrjedhim, banorët e tre fshatrave, ndonëse fqinjë tepër të afërt midis tyre, kanë ardhur, sipas tij, të paktën nga dy vise të ndryshme²⁰. Në këtë mënyrë për studiuesit grekë fronti i studimeve gjuhësore u zgjerua, mbasi për të hulumtuar prejardhjen e banorëve “greqishtfolës” të këtyre fshatrave duheshin bërë kërkime krahasuese të veçanta. Vetë Ev. Ath. Boga bëri përpjekje për të zbuluar atdheun e hershëm të këtyre banorëve. Me këtë rast ai citon profesorin e mjeksisë legale Aleks Pali (me origjinë nga Dhërmiu), i

¹⁹G.Stadtmüller. *Ta problēmata ths istorikhs diereunhsews ths Hpeirou* . Ηπειρωτικά Χρονικά 9 (1934), 155 (Sipas D. V. Vaiakakos. *Po aty*, f. 14)

²⁰ Ev. Ath. Boga. *Po aty*, ff. 77-97.

cili në mes të shek. XIX ka pohuar se greqishtja e folur në Dhërmi kishte afëri me të folmen greqishte të Sinopit, Kerasuntës dhe Trapezuntës që ndodhen në Azinë e Vogël në brigjet e Detit të Zi²¹. Teza iu duk atij pak e besueshme prandaj hoqi dorë prej saj. Madje, ai parashtroi tezën se të dy të folmet greqishte të Himarës i përkasin greqishtes jugore dhe “me karakteristika të veta origjinale të të folmeve të tjera të Epirit të Veriut”. Por edhe këtë tezë, e cila mund ta çonte në dialektet e greqishtes veriore të ishujve të Jonit, ai nuk e shkoqiti më tej. Ai u kthye në pikëpamjen tradicionale të V. D. Zoto-Molosoit, sipas të cilit prejardhjen e tyre himariotët e kanë nga krahina e Manit në Peloponez.

Siç shihet, përpjekjet e studimtarëve helenë për të ndriçuar përkatësinë greke të banorëve të tre fshatrave “greqishtfolëse” të Himarës pa burime dokumentare historike, por vetëm me pikat e takimeve dialektore me një nga të folmet e greqishtes në hapësirën e Helladës, nuk kanë dhënë rezultate bindëse. Kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh se gjuhësia është për historinë një disiplinë ndihmëse. Si rrjedhim, rezultatet e saj bëhen deri diku të pranueshme (të paktën për periudhat mesjetare e këtej), nëse ato gjejnë mbështetje, sadopak, me burime dokumentare historike dhe ca më tepër nëse ato pajtohen me logjikën historike dhe nuk bien në kundërshtim me të dhënat që na japin rezultatet e disiplinave të tjera ndihmëse të historisë, siç janë studimet e zakoneve, dokeve, këngëve, valleve, veshjeve, emrave të njerëzve (onomastika), organizimeve shoqërore dhe e drejta zakonore. Nga kjo pikëpamje duhet thënë paraprakisht se materiali etnografik i tre fshatrave “greqishtfolëse” tregon afëri më tepër me atë të trevës së Labërisë Shqiptare sesa me atë të Manit. Madje edhe pikat e takimit me normat zakonore të

²¹A.Pali. *Cwrografia kai Istorja Hpeirou. Pandora 1859 s. 153- 163 kai 1 77–178.* (Sipas Ev. Ath. Boga. *Po aty*, f. 77).

Himarës me ato të Manit na çojnë, sikurse u tha, në origjinën shqiptare të atyre normave. Studimtari grek. D. Vajakakos, një gjuhëtar, duket se e kuptoi dobësinë e metodologjisë që kanë ndjekur kolegët e tij për të zbardhur origjinën greke të himariotëve vetëm me hulumtimet gjuhësore. Këtë dobësi e pohon kur thotë se studimet gjuhësore mbi të folmen e Himarës kanë dhënë deri sot vetëm *shenja* dhe jo *fakte*. Për këtë arsye ai iu përvesh hulumtimit të burimeve dokumentare për të dëshmuar me anën e tyre prejardhjen greke të himariotëve. Kësaj çështjeje ai i kushtoi dy punime studimore: njëri “Himara e Epirit të Veriut dhe Manit nga pikëpamja gjuhësore dhe folklorike”, tjetri “Kontribut në studimin mbi karakteristikat idiomatike gjuhësore të Himarës”.²² Ne këtu do t’u referohemi dy punimeve të D. Vajakakosit, mbasi në to janë përmbledhur të gjitha argumentat historikë që studimtarët grekë kanë mundur të rreshtojnë për të vërtetuar prejardhjen greke të banorëve të tre fshatrave të Himarës. Pra këtu do të përqëndrohemi vetëm në shoshitjen e burimeve dokumentare historike, të cilat për fat të mirë nuk mungojnë, madje janë relativisht të pasura, aq më tepër që rezultatet e studimeve dialektologjike të paraqitura nga studiuesit grekë janë, sipas pohimit të tyre, ende të diskutueshme.

Mjafton të përmendim gjuhëtarin e njohur grek G. Anagnostopulli, i cili ndërsa nga njëra anë pranon se greqishtja e Himarës ka afëri me idiomën greqishte të Manit, nga ana tjetër shfaq rezerva, mbasi siç thotë ai “nuk kemi ndonjë studim gjuhësor dhe një fjalor të plotë dhe të saktë të gjuhës që flitet në Himarë për ta krahasuar atë me të folmen e Manit, për të cilën gjithashtu

²²D. Vauacacos. *Il wssika kai laografika Cimaros B. Hepeirou kai Manis*. Në: Β Συμποσιο Ἰλωσσολογιασ του Βορειοελλαδικου Χωρου, 13–15. Απριλιου 1 979. Thessaloniki 1983. Poai. *Sunbol h eis thn mel etin tou gl wssikon idiwmatos th s Cimaros Boreion Hpeirou*. Në: Πρακτικα Α Πανελληου Επιετιμονικου Συνεδρι ου. Κονιτσα 22–24 Αυγουστου 1987. Athinai 1988.

nuk kemi dijeni të plotë dhe të saktë”²³. Pra kemi të bëjmë me krahasime mes dy të panjohurave. Por, D. Vajakakos megjithëse deklaroi se: “Është e vështirë të vendosësh me bindje të plotë në lidhje me prejardhjen e himariotëve, qoftë për njërin, qoftë për tjetrën tezë, mbasi kemi të bëjmë me shenja dhe jo me prova, pra jo me fakte historike të shkruara që të dëshmojnë vendosjen e maniotëve në Himarë”, ai e pranon si të mirëqënë prejardhjen e himariotëve nga Mani.

Pjesa më qendrore e punimit të D. Vajakakos, fillon pikërisht kur ai rreshton burimet dokumentare në favor të prejardhjes greke të himariotëve nga Mani. Sipas tij, pikënisja e shtegtimit të maniotëve drejt Himarës fillon me Traktatin e Paqes turko-venedikase të përfunduar më 25 janar 1479. Në bazë të këtij traktati Republika e Shën Markut ia dorëzonte Turqisë krahinën e Manit, në cepin jug-perëndimor të Peloponezitet. Por banorët e Manit e kundërshtuan dorëzimin e tyre tek turqit dhe vendosën të rezistonin me

Figure Harta e Peloponezitet me Gadishullin e Manit.

armë. Midis vullnetarëve që i shkuan Manit për ndihmë ishte edhe kapedani Korkondil Klada nga qyteti fqinj i Koronës bashkë me luftëtarët e tij, të cilët shërbenin si stratiotë nën urdhërat e Venedikut. Një vit më vonë, në janar 1480 pas protestave të sulltanit, republika e dënoi me ashpërsi vazhdimin e rezistencës nga K. Klada. Pas dënimit nga Venediku K. Klada me 50 luftëtarët e tij, në pamundësi për t’u kthyer në vendlindjen e tij, në Koronë, e cila ndodhej ende nën zotërimin e Republikës së Shën Markut, u larguan në prill 1480 nga Moreja dhe u vendosën si refugjatë në Pulje, në Mbretërinë e

²³*Il wssika anal ekta. Braceia episkophsis tw n hpeirwtikwn idiwmatwn, Aθηνα 36 (1925), ff. 62-63 (Sipas D. V. Vayacacos, Po aty, f. 11)*

Napolit. D. Vajakakos vazhdon të tregojë se një vit e gjysëm më vonë, në gusht 1481, K. Klada me luftëtarët e vet mori pjesë në ekspeditën që Gjon Kastrioti ndërmori nga Pulja në Himarë dhe se pas ekspeditës nuk u kthye më në Itali. Pra sipas tij është pikërisht me këtë ekspeditë të vitit 1481 që u krye kolonizimi i Himarës nga maniotët “grekë”. Pastaj shton se këta maniotë *duhet* të kenë gjetur në Himarë një popullsi të vjetër greke. Sikurse shihet praninë e një popullsie më të hershme greke në Himarë (tezë e përmendur më parë nga M. Dhendhiani), edhe D. Vajakakosi e ka me hamëndje.

Tregimi i D. Vajakakosit ka një varg dobësish dhe pasaktësish, tre prej të cilave, më kryesoret, do t’i shoshitim me anë të dokumentacionit historik bashkëkohor: nëse Korkondil Klada ishte grek apo shqiptar; nëse kishte ose jo në Himarë banorë grekë para ekspeditës së Gjon Kastriotit në vitin 1481 dhe e treta, nëse qëndroi ose jo ai me shokët e tij në Himarë pas përfundimit të ekspeditës së Gjon Kastriotit.

Figure Ushtarë shqiptarë në Koron, pranë Livadhjasë. Choiseul-Gouffier (1782).

Figure :Familje shqiptarësh në More. A. S. Castellan (1797).

Gadishulli i Manit ndodhet në provincën e Lakonisë, e cila shtrihet në kepin jugperëndimor të Moresë. Përballë gadishullit janë dy qytete kryesore bregdetare të Lakonisë, Korona dhe Modona (Mothona). Shqiptarët të shpërngulur nga viset jugore të Shqipërisë së sotme janë vendosur në Lakoni

që në shek. XIV kur ajo ndodhej nën sundimin e despotatit bizantin të Mistrës. Prania e tyre në Mani, sidomos në Korone dhe Modone vërtetohet nga aktet kancelareske dhe kronikale venedikase, të zbuluara dhe të botuara në origjinal nga historiani i njohur grek i shek. XIX K. Sathas²⁴. Ato flasin gjithashtu për rolin tepër aktiv që arvanitët e Lakonisë luajtën në luftën kundër invazorëve osmanë. Madje, sikurse dëshmon historiani i njohur gjerman J. Hammer, kur në mes të shek. XV dy despotët bizantinë të Peloponezit, vëllezërit Dhimitër Paleologu dhe Thoma Paleologu ishin në konflikt me njëri-tjetrin dhe secili prej tyre përpiqej të siguronte përkrahjen e sulltanit kundër vëllait të vet, vetëm shqiptarët qenë ata që luftuan kundër turqve dhe kundër grekëve që ndihmonin turqit. Pesha e shqiptarëve si forcë politike dhe ushtarake ishte aq e rëndësishme, sa qeveritari bizantin i krahut të Manit, Manuel Kantakuzeni, me qëllim që të tërhiqte simpatinë e tyre, thotë Gjon Muzaka në “memoriet e tij” të shkruara më 1510, ndërroi emrin e tij grek Manuel dhe të gruas së tij Maria, duke marrë emrin shqiptar *Gjin*, kurse gruaja e tij *Kuqe*. (*Emanuel Catacusino il quale signoreggiava il Braccio de Mainna...e mutarli il nome e chiamorno Ginno, e la moglie ch’avea nome Maria, la chiamorno Cucchia, e sono nomi Albanesi*).²⁵ Praninë e shqiptarëve në Lakoni dhe mbiemrin e dyfishtë – njërin grek (Kantakuzinos), tjetrin shqiptar (Gjin) - të qeveritarit të Manit (Μανουλι Καταχουσηνου του Τχινου) e pohon edhe G. D. Kapsalis, autori i zërit “Mani” të Enciklopedia e madhe greke²⁶.

²⁴ C. N. Sathas. *Documents relatifs e l’histoire de la Grece au Moyen Age, tome I-IX*, Paris 1880-1890.

²⁵ G. Musachio. *Historia e genealogia della casa Musachia (1510)*. Në: C. Hopf. *Chroniques Greco-Romanes, inedites ou peu connues*. Berlin 1873, f. 331.

²⁶ G. D. Kapsalis. *Manh*. In: Meg. Ell. Enk. Vol. XVIII. Athinë 1931. f. 307.

Do të shkonte gjatë të përmendnim këtu aktet venedikase të botuara nga Sathas, të cilat dëshmojnë për rolin që luajtën shqiptarët e Lakonisë dhe të provincave të tjera fqinje, të Moresë (Elidë, Argolidë etj.) gjatë viteve '50, '60, '70 të shek. XV të frymëzuar nga rezistenca e Skënderbeut në Shqipëri, kundër invazorëve osmanë. Duhet thënë gjithashtu se qëndrimi i lëkundshëm që mbajtën arkondët grekë të Moresë ndaj invazorëve osmanë, i detyroi krerët shqiptarë të kësaj treve, në mënyrë të veçantë ata të Lakonisë, që të kërkonin mbështetje te Republika e Venedikut dhe t'i shërbenin asaj si stradiotë, për disa dhjetëra vite me rradhë, për mbrojtjen nga pushtimi turk të viseve të tyre bregdetare që ndodheshin nën zotërimin e saj.

Korkondil Klada, i cili sipas historianëve helenë kryesoi koloninë “greke” të vendosur me hamëndje në Himarë nuk ishte *grek* por *shqiptar* (*arvanit*). Ai ishte një stratiot jo nga Mani, por nga Korona. Ai ishte pinjoll i Kladëve ose i Kladajve, një bashkësi arvanite e Koronës. Për përkatësinë shqiptare të bashkësisë së Kladajve po sjellim këtu një dëshmi dokumentare. Ajo vjen nga një letër e një funksionari venedikas që banonte në trevën e Koronës, drejtuar më 15 shkurt 1482 dogjit të Venedikut. Sipas tij, vojvoda i sanxhakbeut turk të kësaj treve ishte me *kombësi shqiptare* (*che he de natione albanese*) dhe farefis i Buzikejve të këtushëm, pjesëtarë të bashkësisë (*setta*) së Kladajve, pra kuptohet se edhe Kladët i përkisnin kombësisë shqiptare. Pastaj shton se ky vojvodë sëbashku me një funksionar tjetër të këtij sanxhaku – një subash, *gjithashtu me kombësi shqiptare* (*etiam de natione albanese*), qenë ngarkuar prej sanxhakbeut që të ndërmjetësonin për t'i pajtuar me të dhe të sillnin nën bindjen e tij kryengritësit Meksi Buziki (*Mexa Busichi*) kryetar i bashkësisë së Kladajve (*capo de la setta de i Cladioti*), vëllezërit e tij Pjetër Buziki, Duma Buziki si dhe Zagan Karatollën me Marin Klimentin, gjithashtu nga bashkësia e Kladajve. Kuptohet më në

fund se kjo trevë kishte plot banorë arvanitë përderisa sanxhakbeu turk qeveriste këtu me vojvodë dhe subashë arvanitë, madje edhe kundërshtarët e tij, bashkësia e Klada, ishin arvanitë. Me një fjalë pjesëtarët e repartit të kryesuar nga Korkondil Klada që morën pjesë në ekspeditën e Gjon Kastriotit, nuk qenë grekë, por shqiptarë (arvanitë). Madje shqiptarësia e K. Kladës dhe e luftëtarëve të tij duhet të shpjegojë edhe pjesëmarrjen e tyre në ekspeditën e udhëhequr nga biri i Skënderbeut.

Në lidhje me pretendimin e dytë – se në Himarë kishte banorë të vjetër para “ardhjes” së K. Kladës (1481) - kemi të bëjmë me një tezë që mbetet thjesht një hamëndje. Mjafton të thuhet se në asnjë nga burimet dokumentare ose tregimtare, qoftë antike, qoftë mesjetare, nuk bëhet asnjë fjalë, qoftë edhe tërthorazi për praninë e ndonjë popullsie greke në Himarë. Veç kësaj, nëse himariotët do t’i përkisnin etnikonit helen do të ishte e vështirë për ta që të aderonin në një kuvend kombëtar shqiptar siç ishte Kuvendi i Lezhës i mbledhur më 2 mars 1444. Marin Barleti, i cili e ka zakon të cilësojë kombësinë e figurave historike vetëm kur ata nuk janë shqiptarë, kur vjen fjala për pjesëmarrjen e himariotëve në Kuvendin e Lezhës ai shkruan se: “Në këtë mbledhje historike ata u përfaqësuan nga Andrea Topia, një bujar shqiptar i kulluar”. Pastaj shton: “Topiajt ishin njohur edhe si princër edhe për sundimin e Himarës së Ulksit. Himara është një vend malor kundrejt Korkyrës (Korfuzit – K.F.), ku banon një popull i pamposhtur dhe trim që të mos them luftarak, të cilët ne i quajmë zakonisht Himariotë”.²⁷ Në lidhje me çështjen e tretë – nëse K. Klada me luftëtarët e tij qëndruan ose jo në Himarë – le të lëmë të flasim burimet dokumentare të kohës së ekspeditës së Gjon Kastriotit. Paraprakisht duhet të themi se ato nuk përmbajnë asnjë shënim që t’i cilësojë luftëtarët e K. Kladës si grekë.

²⁷ M. Barleti. *Historia e Skënderbeut*. (Përkthyer nga St. Prifti). Tiranë 1964, f. 93

Siç dihet, ekspedita e Gjon Kastriotit ndodhi fill pasi ushtritë turke zbarkuan në pranverë të vitit 1480 në Pulje dhe pushtun Otranton në tokën e Mbretërisë së Napolit. Një vit më vonë kur furia e sulmeve turke u fashit nga lufta për fron që shpërtheu midis djemve të sulltan Fatiut, Mbretëria e Napolit, vendosi të kalonte në kundërsulm për të dëbuar ushtritë osmane nga Pulja, madje edhe nga Shqipëria. Në këtë projekt një vend të rëndësishëm zinin kryengritjet shqiptare, të cilat do t'i godisnin prapa krahëve ushtritë osmane. Madje vetë shqiptarët morën nismën për të organizuar në Shqipëri një kryengritje në shkallë të gjerë si pjesë përbërëse të koalicionit evropian antiturk. Për këtë qëllim ata ftuan të kthehej nga Italia ku ndodhej i mërguar Gjon Kastriotin, birin e Heroit sëbashku me luftëtarët shqiptarë që ishin me të, për të rimëkëmbur “Principatën e Skënderbeut”. Me këtë ekspeditë që synonte rikrijimin e shtetit të lirë shqiptar, janë të lidhura edhe ngjarjet e Himarës.

Gjon Kastrioti e pranoi ftesën për t'u kthyer në atdhe. Burimi kryesor që kemi mbi ekspeditën e tij është ditari që ka mbajtur për ngjarjet e viteve 1479-1497 kronisti venedikas Stefano Magno, i cili është botuar nga historiani grek C. Sathas²⁸. Fill pas tij, për nga rëndësia vjen kronika e D. Malipieros (një tjetër kronist venedikas, bashkëkohor i St. Magnos), e botuar gjithashtu nga K. Sathas²⁹. Në ditarin e St. Magnos thuhet se: “Popujt e vendit të Gjergj Kastriotit të quajtur Skënderbej, në anët e përmendura të Shqipërisë, dërguan në Pulje njerëz për të kërkuar Gjonin, birin e tij, që të

²⁸ C. Sathas. *Po aty*.

²⁹ C. Sathas. *Po aty*.

shkonte për të marrë në dorë zotërimin e të atit”³⁰. Po në atë vend të kronikës njoftohet se Gjon Kastrioti në atë kohë ndodhej në ushtrinë e dukës së Kalabrisë, Alfonsit Aragonez, biri i Mbretit Ferdinand të Napolit, duke luftuar kundër turqve që mbanin të rrethuar Otrantin³¹. Sipas një shënimi tjetër që përmban ditari i St. Magnos në ushtrinë e dukës së Kalabrisë ndodhej edhe Kostandin Muzaka, një bujar shqiptar, kushëri i parë i Gjon Kastriotit, të cilin e kishin ftuar vetë himariotët për të luftuar në Himarë si kapedan i tyre.³² Duka Alfons e ndihmoi Gjon Kastriotin duke i dhënë atij katër galere që të kthehej në Shqipëri me kushëririn e tij Kostandin Muzakën “sëbashku me shumë burra të vler të ai kishte me vete”. Në kronikë thuhet se bashkë me ta Alfonsi dërgoi “Kladën prej Korone i cili kishte ikur nga Krahu i Manit” (*Clado de Coron el qual era fugido dal Brazo de Maina*). Ekspedita zbarkoi në afërsi të Durrësit. Pasi Gjon Kastrioti me luftëtarët kryen disa luftime nëpër tokë në Shqipërinë e Mesme, një pjesë e tyre udhëtoi nëpër det drejt Himarës. Në lidhje me këto veprime kronisti Stefano Magno njofton se:

“Katër galere të flotës mbretërore, që e kishin sjellur atë në ato anë, me Kladën prej Korone, shkuan duke plaçkitur nëpër ato brigje në dëmin e turqve dhe që andej Klada kaloi nga Vlora dhe shkoi në malet e Himarës, të vendosura në bregdet në kufijtë e vendit të përmendur të Vlorës dhe me punën e tij, ata popuj të atij vendi malor, që janë më shumë se 50 fshatra, qenë ftuar t’i zbonin turqit dhe të rifitonin lirinë; dhe me galeret e thëna shkoi në kështjellën Himarë, fortesë kryesore e atij vendi, dhe atë fortesë e sulmoi”.³³

Për të përballuar sulmin e himariotëve, njofton kronisti, subashi turk i Himarës i kërkoi ndihmë bejlerbeut Sulejman Alibeut në Vlorë, i cili ishte

³⁰ C. Sathas. *Po aty*, f. 229. Pasazhi që flet për në Himarë është ribotuar në origjinalin italisht i shoqëruar dhe me përkthimin shqip nga I. Zamputi në: Dokumenta të shek. XV për historinë e Shqipërisë. Vëll. I (1479-1499). Tiranë 1967, ff. 70-73.

³¹ C. Sathas. *Po aty*, f. 229.

³² C. Sathas. *Po aty*, f. 229.

³³ C. Sathas. *Po aty*, f. 229.

duke u përgatitur për të rifilluar veprimet ushtarake kundër Otrantit në Pulje. Bejlerbeu u nis vetë në ndihmë të subashit të Himarës me një repart ushtarak prej 3000 vetësh të armatosur. Por sikurse thuhet në kronikë:

“Popujt e malit të përmendur (himariotët me në krye Kostandin Muzakën – K.F.) bashkë me shumë balesterjerë të galereve shkuan tek një qafë mali (pa dyshim në Qafën e Llogorasë – K.F.) e mundën dhe e kapën (bejlerbeun – K.F.) me shumë turq, kurse shumë të tjerë i vranë. Me të kapur e me të vdekur qenë rreth 1000 vetë. Të tjerët u kthyen mbrapsht”.

Kronisti St. Magno shënon se pasi e mori vesh këtë disfatë, subashi i Himarës u arratis me anije në Korfuz, kurse “Klada që kishte ardhur me galeret aty, hyri dhe mori edhe kështjellën e Sopotit që ishte në malet e përmendura”.

Pasi u çlirua Himara, Gjon Kastrioti i kërkoi kushërit të vet, Kostandin Muzakës, që t’ia dorëzonte atij bejlerbeun Sulejman Alibeun, pasi i dha një shpërblim prej 1500 dukatësh. Pastaj Gjoni ua dha bejlerbeun “atyre të flotës mbretërore (napolitane – K.F.)” për 4000 dukatë, të cilët ia dorëzuan pastaj dukës së Kalabrisë Alfonsit, i cili nga ana e vet e liroi pasi mori nga bejlerbeu 20000 dukatë. Në kronikë thuhet se ky lajm arriti më 23 shtator 1481³⁴.

Ekziston një letër e nënshkruar nga Kostandin, me mbiemrin e dyfishtë Muzaka Karli, i cili cilësohet kushëri i parë (*fratello consobrino*) i Gjon Kastriotit, drejtuar para 16 gushtit 1481 dukës së Kalabrisë në të cilën pretendon se ka qenë ai që e udhëhoqi kryengritjen e himariotëve dhe realizoi çlirimin e Himarës. Në letër thuhet ndër të tjera:

“Të nderuarit dhe të urtit zot Dukë, nga biri yt kalorësi Kostandin Muzaka Karli. Ta dini sesi zotëria jote më dërgoi ndër Kurlisej (Kurvelesh – K.F.) dhe e pushtova të gjithë Shqipërinë dhe sa flamuj që ajo kishte; pushtova edhe fshatrat e Skimarisë

³⁴ C. Sathas. *Po aty*, f. 229.

(Himarës – K.F.) dhe kështu shtira në dorë Cymaria-n (Himarën) dhe vrava njëmijë e gjashtëqind turq kurse njëmijë e pesëqind i kemi kapur të gjallë³⁵”.

Përkundrazi sipas Analeve të D. Malipieros, është Gjon Kastrioti ai që e çliroi Himarën. Në shënimin që daton para 15 shtatorit 1481 thuhet tekstualisht: “Djali i Skënderbeut i ftuar prej shqiptarëve, ka kaluar nga Pulja në Shqipëri dhe me ndihmën e himariotëve ka shtënë në dorë shumicën e shtetit atëror dhe ka thyer 2000 turq që i kanë kundërshtuar”.³⁶ Nga këto njoftime kuptohet se himariotët nuk mund të ishin grekë, përderisa ata luftuan me trimëri dhe me vetmohim për të rimëkëmbur shtetin e lirë shqiptar.

Veç kësaj, as në njoftimet që flasin për ngjarjet e vitit 1481 nuk del prania e banorëve grekë në Himarë. Që nuk kishte luftëtarë grekë në ekspeditën e Gjon Kastriotit del edhe nga një akt i dukës së Kalabrisë Alfonsi Aragonez, i cili përmban udhëzimet që ai i dërgoi mag. Gjon Albinos (*Giovani Albino*) i ngarkuar si qeveritar i Himarës së çliruar. Në këto udhëzime ai e porosiste ndër të tjera që në Himarë “të fliste e të orvatej me ata zotëri shqiptarë (*con quelli s. Albanisi*) në mënyrën dhe formën që do t’i dukej më me vend që t’ia dilte për të marrë pashën (Sulejman Pashën e zënë rob – K.F.)”. Më tej ai e porosiste gjithashtu G. Albinon që t’u lutej Kostandin (Muzakës – K.F.), Bernardinit, z. Francit dhe “zotërive fisnikë shqiptarë dhe shqiptarëve të tjerë po të jetë nevoja” që të merrnin pjesë në

³⁵ M. Šufflay. *Shqiptarët dhe serbët* (Përkthimi shqip). Tiranë 1926, f. 72

³⁶ D. Malipiero. *Annali Veneti dall’anno 1457 al 1500 del senatore (Domenico Malipiero) ordinato e abbreviati dal senatore Francesco Longo ecc.*, Firenze, G. P. Vieusseux, 1843, f. 132.

sulmin kundër flotës turke dhe qytetit të Vlorës³⁷. Pra as këtu nuk përmenden luftëtarë grekë.

Ekspedita e Gjon Kastriotit dhe e kushëririt të tij Kostandin Muzakës në Himarë pati jetë tepër të shkurtër. Me operacionet që ndërmoi komandanti turk i Vlorës kundër Himarës, Gjon Kastrioti dhe Kostandin Muzaka, sëbashku me pjesëmarrësit e ekspeditës, ndoshta dhe me disa banorë vendës, u kthyen përsëri në Pulje të Italisë.

Që pas largimit të tyre K. Klada të ketë qëndruar në Himarë, përveçse nuk ka dëshmi dokumentare, është e pabesueshme, edhe për një arsye tjetër. Stratotët arvanitë erdhën në Himarë si luftëtarë pa familjet e tyre. Edhe sikur familjet t'i kenë sjellë më vonë do të ishte e pakuptueshme të pranohet se Klada me arvanitët e tij, të cilët u larguan nga Korona për të shpëtuar nga zgjedha turke të kenë braktisur Kalabrinë mikpritëse (ku arvanitët nga Korona themeluan fshatin e sotëm arbëresh Shën Mitër Korone – *San Demetrio Corone*) dhe të jenë vendosur përsëri në një vend si Himara me toka të pakta bujqësore dhe për më tepër që ndodhej thikë më thikë me zgjedhën osmane. Siç shihet, këtu nuk ka vend për të besuar se në Himarë më 1481 u vendosën kolonë grekë. Aq më tepër që tre vjet më vonë kronisti venedikas St. Magno kur flet për kryengritjen e Himarës të vitit 1484 i cilëson himariotët pa mëdyshje shqiptarë (*Quelli di Zimera, populi Albanesi*).³⁸

Më në fund emri i Korkondil Kladës ose thjesht i Kladaeve nuk ndeshet fare në traditën popullore të trevës himariote. Përkundrazi në traditën popullore të Himarës, Dhërmiut dhe Palasës ndeshet ende sot

³⁷ Ioanis Albini Lucani. *De Gestis Rerum Neapo. Ad Aragonia qui Extant Libri Quatour* etc. Apud Iosephum Cachium, 1588, ff. 200-204. I. Zamputi. Po aty, Pjesa II, f. 71

³⁸ C. Sathas. *Po aty*, f. 94

kujtimi që e çon prejardhjen e tyre tek epoka e Skënderbeut, madje aty-këtu edhe nga Kruja e Skënderbeut. Emrin e Kladës, apo të Koronës, apo të Manit nuk e njeh as gjenerali himariot Spiro Milo, i cili mori pjesë, me nxitjen e mbretit të Napolit, në krye të vullnetarëve himariotë në revolucionin çlirimtar grek të vitit 1821. Në jetëshkrimin e tij hartuar në bazë të shënimeve të arkivit të tij personal thuhet:

“Ka lindur në shkurt të 1800 në fshatin Himarë të rrethit të Akrokeraunit Oreon të Epirit. Paraardhësit e tij që nga epoka e Skënderbeut shërbenin si ushtarakë të mbretit të Napolit në reparte të veçanta, që herë cilësoheshin shqiptare e herë maqedone dhe shumë prej tyre janë ngjitur në grada të larta duke përdorur emrin Spiro, të fisit që sot quhet Spiridhon. Më 1810 gjyshi i gjeneralit, Spiro Milo (Mihal) Johanis Spiros, komandonte efektivin e shqiptarëve në Siqili me gradën e kolonelit, mori me vete dhe nipin e tij për t’i dhënë atij edukatën e nevojshme. Më 1818 ai u dërgua në Epir tek të afërmit e tij, por ai donte që të inkuadrohej në ushtrinë e Napolit”.³⁹

Pra dëshmia e gjeneralit Spiro Milo, një himariot dhe njeri i shkolluar, një ndër heronjtë e revolucionit çlirimtar grek, i cili nuk e njeh as legjendën e Manit, as emrin e Korkondil Kladës, jo vetëm se është më e hershme por edhe më e besueshme se tregimi i V. D. Zoto-Molosoit dhe ca më tepër se pohimet e mëvonshme të historianëve helenë mbi origjinën greke-maniote të himariotëve.

Ekspedita e Gjon Kastriotit, sidomos veprimet e saj në Himarë kundër bazës ushtarake turke të Vlorës i tregoi Portës së Lartë rrezikun që paraqisnin himariotët kur ajo të rifillonte ekspeditën në Pulje të Italisë. Për këtë arsye sapo sulltani i ri Bajaziti II e kapërceu krizën politike që

³⁹St.Papageorgiu. *To arceio Spiromliou*. Në: “Δελτιν της Ιστορικης και Εθν ολογικης Εταιρειας της Ελλάσας. Athinë 1981, f. 117.

shpërtheu në rradhët e turqve mbas vdekjes së sulltan Mehmet Fatiut, ai ndërmoi më 1484 dhe pastaj 1486 dy ekspedita ushtarake kundër Himarës, të cilën St. Magno e cilëson “vendi i shqiptarëve”⁴⁰. Pas dështimit që pësoi edhe një ekspeditë e tretë e tij më 1488 Bajaziti II me në krye vetë Sulltanin ndërmoi në vitin 1492 një fushatë ushtarake “perandorake” kundër himariotëve. Rezistenca që zhvilluan himariotët kundër furisë osmane përbën një nga faqet më heroike të historisë së tyre. Përkatësinë etnike shqiptare të himariotëve në këtë përleshje epike e pohon përsëri kronisti venedikas St. Magno, i cili shkruan se “turqit pushtuan malet e Himarës, nga Vlora deri në Sarandë...dhe në disa maja të maleve kapën shumë shqiptarë (*molti albanexi*), të tjerët u shpërndarë dhe ikën”⁴¹.

Por banorët e Himarës nuk u ligështuan. Ata e vazhduan rezistencën derisa turqit u detyruan të hynin në marrëveshje me ta. Në bazë të marrëveshjes, kalaja e Himarës e Sopotit u rrënuan, kurse himariotët pranuan, njofton St. Magno, t’i paguanin haraçin sulltanit. Pagesa e haraçit do të thoshte se sulltani hiqte dorë nga vendosja e regjimit feudal-ushtarak të timareve në krahinën e Himarës. Duke paguar haraçin, Himara do të administrohej jo në bazë të ligjeve perandorake osmane, por sipas të drejtës zakonore të bashkësisë së saj. Në këtë mënyrë Himara fitonte një autonomi krahinore.

Figure Himara. Gravurë e shek. XIX.

Rezistenca e himariotëve la një përshtypje të thellë në opinionin evropian si luftë e një grushti shqiptarësh e realizuar në kushte tepër të vështira kundër ushtrive osmane. Sëbashku me rezistencën, opinionin publik

⁴⁰ C. Sathas. *Po aty*. Vëll. VI, f. 236.

⁴¹ C. Sathas. *Po aty*, f. 237.

evropian, mori dijeni edhe për statusin e himariotëve – si një bashkësi që vetqeverisej në bazë të venomeve të tyre tradicionale. Dëshmi kemi për këtë “privilegj” humanistin dhe filozofin hollandez, bashkëkohës të kësaj rezistence, Erazmin e Roterdamit (1469-1536), i cili në veprën e tij *Consultatio de Bello Turcis inferendo*, shkruan:

“Sulltan Bajaziti *pushtoi* fiset që banonin pranë maleve Këraune, të cilat deri ato ditë kishin qenë përherë të lira, i nënshtroi me dhunë dhe i vuri nën zgjedhën e turkut (sulltanit)”.⁴²

Veç kësaj, rezistenca heroike e himariotëve, e cila vahdoi edhe në shekujt e mëvonshëm, solli popullarizimin në Evropë të emrit të Himarës dhe të banorëve të saj, si një bashkësi e veçantë e kombësisë shqiptare, afërsisht njësoj si ndodhi më vonë me rezistencën e bashkësisë së Mirditës dhe të banorëve të saj, mirditorëve. Kjo është arsyeja përse në aktet kancelareske dhe traktatet historike të shekujve XVI-XVIII, ata quhen thjesht himariotë dhe rrallë e ek cilësohen si shqiptarë. Por kjo nuk do të thotë se himariotë kur nuk cilësohen shqiptarë, ose kur thuhet “shqiptarët dhe himariotët”, të dytët qenë grekë, siç e shpërdorojnë zakonisht historianët helenë. Është e njëjta gjë se kur ndeshim në burimet historike “shqiptarët dhe mirditorët”, ose “shqiptarët dhe kelmendasit”, nuk kemi të drejtë të themi se të dytët (mirditorët ose kelmendasit), nuk qenë shqiptarë.

Por nga marrëveshja e vitit 1492 nuk mbetën të kënaqur as turqit, as himariotët. Himariotët nuk mund ta duronin haraçin, i cili ishte një peng nënshtrimi dhe ishin gati të rifillonin kryengritjet për të rifituar lirinë e plotë sapo të gjenin një përkrahje në arenën ndërkombtare. Nga ana e saj, administrata perandorake vazhdonte ta shihte me dyshim autonominë lokale të himariotëve dhe priste rastin që t’i nënshtrohte ata plotësisht. Si rrjedhim,

⁴² C. Sathas. *Po aty*. vëll. VI, f. 239.

turqit herë pas here ndërmerrnin ekspedita ushtarake kundër Himarës për të vendosur regjimin e timareve, regjim i cili do t'ua hiqte autoritetin pushtetor krerëve liridashës të Himarës. Por himariotët nga ana e tyre vazhdimisht përgjigjeshin me një rezistencë të armatosur dhe disa herë me sulme kundër bazave ushtarake osmane. Me të tilla përlëshje midis qeveritarëve osmanë dhe himariotëve të lirë është e mbushur historia e Himarës gjatë shekujve të sundimit turk, kurse rezistenca e tyre është pasqyruar vazhdimisht në aktet kancelareske dhe botimet historike evropiane. Kështu p.sh. në një memorial hartuar në muajin teor të vitit 1500, i cili ruhet në bibliotekën Laurentiane të Firences (Itali) dhe është botuar nga historiani rumun N. Jorga⁴³, thuhet ndër të tjera:

“Këtu vendasit kanë me shumicë ujëra të kulluara: dikush rreh detin për të nxjerrë lehtësisht gjërat e nevojshme, dikush tjetër qëndron fare i varfër sepse nuk mund të udhëtojë me lehtësi në brendësi të vendit. Banorët e këtij vendi janë ilirë, që tani quhen shqiptarë, megjithëse *përdorin edhe gjuhën greke, por në mënyrë shumë të huaj*...Këtu shpesh nënshtrohen nga turqit, pasi bëhet një kërdi e madhe mbi ta dhe në krye të dy ose tri viteve, sërish dalin dore, me shpresë sidomos se nga ndonjë anë do të shkëlqejë ndonjë ndihmë e dhëmbshur dhe të thuash me një luftë të shpallur të përhershme, përherë sillen me guxim kundrejt atyre dhe kështu aty askush nuk e përfill autoritetin dhe ligjin e tyre...(*Hic, aquis lucidis indigenisque abundans, altera mari commeatus et supplementa recipere facilis, altera, pauci admodum custodientibus, qua continenti opponitur, superari non potest. Accole ejus Illyrii, quos nunc albaneses nuncupant, quamvis greca quoque lingua, perbarbare tamen, utantur...*)”

Figure Bregu i Himarës me hartën e Mesdheut Qëndror. Battista Agnese (1550).

Pra, himariotët e flisnin keq greqishten, pasi për ta ishte gjuhë e huaj. Edhe kronisti St. Magno duke folur për veprimet e armatosura të venedikasve më 1501 në grykën e Vjosës thotë se në bashkëpunim me ta në këto veprime morën pjesë edhe shqiptarët himariotë (*albanesi zimaroti*).⁴⁴

⁴³ N. Jorga. *Notes et extraits pour l'Histoire des Croisades au XV-e siècle*. Vëll. V. Paris 1907, ff. 313-333.

⁴⁴ M. Sanuto. *Diari*. Vëll. IV, f. 13. Në shqip: I. Zamputi. *Po aty*. dok. nr. 210, f. 283, f. 1021, f. 1020.

Udhëtari frëng Denis Possot në veprën e vet të hartuar në vitin 1532, e ndan Shqipërinë në tre pjesë – në Shqipërinë e zotëruar nga venedikasin, në Shqipërinë e sunduar nga turqit dhe në Shqipërinë e sunduar nga vetë shqiptarët (*la troisieme est en la seigneurie des Albanoyes*).⁴⁵ Duke folur për zonat “e lira” të Shqipërisë, ai njofton se burrat e kësaj pjese shkojnë në luftë kundrejt pagesës, se ata “kanë 20000 kalorës për të shkuar kundër armiqve në Turqi dhe ata banojnë në një vend e në një pjesë të Shqipërisë që tani quhet Himarë” (*ilz ont bien vingut mille gens se cheval pour aller contre les ennemis de Turquie. Et se tiennent a un lieu e t partie d’Albanie que maintenant on apelle Chimere*). Sikurse shihet këtu Himara është në vështrimin më të gjerë kur me emrin e saj përfshihej gjithë Labëria, fshatrat e së cilës sot bëjnë pjesë në rrethin e Vlorës, Tepelenës, Gjirokastrës, Delvinës dhe Sarandës.

Në vitin 1537 sulltan Sulejman Kanuniu vendosi të realizonte ëndrën e paraardhësve të tij, pushtimin e Italisë. Për këtë qëllim erdhi vetë në Vlorë sëbashku me 20000 ushtarë dhe me një shumicë anijesh luftime. Kur në korrik arriti në trevën e Vlorës vendosi, ashtu si pararadhësit e tij (sulltan Fatiu dhe sulltan Bajaziti II), që përpara se të ndërmerre ekspeditën kundër Italisë, të nënshtronte himariotët për të parandaluar goditjet prapa shpine të tyre. Për

⁴⁵ D. Possot. *Le voyage de la Terre sainte compose par Maitre D. P. et acheve par Messire Charles Pilippe, seigneur etc.* 1532. Publie et annote par Ch. Schefer etc. Paris, Ern. Leroux edit MDCCCXC.